

**AKT THEMELIMI  
(KONTRATË)**

**I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
SBD-FAJA - Sh.p.k.**

Unë , **Mustafa HORESHKA**, i biri i Xhelalit, lindur me **26.06.1985** në fshatin Sohodoll i Madh-Kastriot/Dibër, banues në fshatin Sohodoll i Madh/Nj.Adm.Kastriot, **Bashkia/ Dibër**, zotërues i Kartës së Identitetit **nr.personal/personal no. I50626086M** madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

Sot me datë **12.07.2021**

**V E N D O S A**

**Neni 1**

Të themeloj një Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar për të ushtruar veprimtari ekonomike të EMËRTUAR : **SBD-FAJA - Sh.p.k.**

**Neni 2**

Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar dhe përballon humbjet deri në kufirin e vlerës së derdhur në kapitalin themeltar.

**Neni 3**

**Shoqëria e ka SELINË në Njësinë Administrative të qytetit PESHKOPI, Bashkia/Dibër në adresën : Lagjja "Gjok Doçi", Rruga "Gj.Doçi", Dyqan farmacie veterinare në katin përdhe, ndërtesa nr. 13/8-N1.**

Ajo ka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë teritorit të Republikës së Shqipërisë, filiale, agjensi, përfaqësi, seli sekondare dhe t'i suprimojë ato.

**Neni 4**

Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje me një kufi të pacaktuar, **mbi 15 vjet.**

**Neni 5**

Kapitali Themelor i Shoqërisë do të jetë **1000 Lek (Njëmijë lek).**

Kapitali i shoqërisë zotërohet nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë, **Mustafa HORESHKA.**

Ortaku i Vetëm **Mustafa HORESHKA, zotëron 100 %** të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga **1 pjesë e vetme (Një kuotë)** me vlerë nominale prej **1000 Lek (Njëmijë lek).**

**Neni 6**

Në librin e llogarisë që do të krijohet në Shoqërinë Tregtare do të shënohet dhe kapitali i derdhur nga Ortaku i Vetëm. Rritja e kapitalit nuk është e kufizuar.

**Neni 7**

Të gjitha pjesët e kapitalit themelor janë tërësisht të shlyeshme dhe të nënshkrueshme nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë.

**Neni 8**

**Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë :**

**Farmaci dhe klinikë veterinare. Magazinin produktesh. Kultivim dhe ruajtje të**



kulturave bujqësore për blegtorinë.Shërbime për pastrim, higjenizim, dezinfektim, deratizim, dezinfektim, dezvaranifikim. Tregtim produktesh, materiale dhe pajisje për pastrim, higjenizim, dezinfektim, deratizim, dezinfektim, dezvaranifikim.Tregtim premikse dhe aksesorë për blegtori, bletari dhe bujqësi.Veprimtari bujqësore e blegtorale. Tregtim pajisjesh dhe materiale mjeksore.

#### **Neni 9**

Marëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit që lidhet midis palëve në mbështetje të Ligjit Nr.7961 Dt.12.07.1995”Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”,si dhe akteve të tjera nënligjore të dala në zbatim të tij.

#### **Neni 10**

Ortaku i Vetëm i shoqërisë nuk kufizohet në rritjen e kapitalit të shoqërisë.

#### **Neni 11**

Shoqëria vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejta e detyrime vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj.Ortaku i Vetëm Themelues mbart rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë vetëm në nivelin e kapitalit të investuar në shoqëri.

#### **Neni 12**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private të shoqërisë, midis punonjësve brenda saj dhe me të tretët, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, atëherë ato zgjidhen me rrugë gjyqësore në gjykatën kompetente.

#### **Neni 13**

Shoqëria do të ketë vulën e saj ku janë përcaktuar dhe inicialet e emërimit të shoqërisë.

#### **Neni 14**

Pasuria e shoqërisë mund të sigurohet pranë shoqërive të sigurimit duke respektuar ligjet që veprojnë në fushën e sigurimit dhe risigurimit.

#### **Neni 15**

##### **Organet e Shoqërisë SBD-FAJA -Sh.p.k.**

- Asambleja e Ortakë/ortaku i vetëm
- Administratori/ët e Shoqërisë

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në Statutin e shoqërisë.

**Administrator** i shoqërisë do të jetë **Znj. Elda HORESHKA**, zotëruese e Kartës së Identitetit **nr.personal/personal no. J05617003I**

Modalitetet për ndryshimin e Administratorit/ve si dhe kompetencat rregullohen nga **Statuti i Shoqërisë dhe Ligji Nr 9901 Dt.14.04.2008”Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”**.

Ky Akt Themelimi është përpiluar në katër kopje me vlerë të njëjtë me origjinalin dhe është nënshkruar me vetëdije dhe vullnet të plotë prej meje personalisht.

**THEMELUESI I SHOQËRISË TREGTARE“**

**SBD-FAJA - Sh.p.k.**

**Mustafa HORESHKA**

MUSTAFA HORESHKA

Peshkopi, me 12 Korrik 2021

